

Konform nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr-54/2005, datë 10.5.2005, nenit 12 alineja 1 dhe 2 dhe nenit 17 alineja 1 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 alineja 4 pika (b) dhe të nenit 27 alineja 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur e vet të mbajtur më 18 tetor 2012 miratoi këtë:

V E N D I M
PER MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN (PRRU) "TREGTI DHE
INDUSTRI TE VOGEL" TË QYTETIT TË PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet PRRU-së "*Tregti dhe Industri te Vogël*" të Qytetit të Prizrenit, e cila është hartuar nga NPT "PRIMA-ENGINEERING,, nga Prishtina (bartës të hartimit të planit), e njëjta e hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Prizrenit, si dhe konform Ligjit mbi Planifikim Hapësinor Nr.2003/14 date 03.07.2003.

Pjesë përbërëse e këtij PRRU-së do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimit në këtë hapësirë.

Pjesa grafike duhet të përmbajë:

- paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban.

Neni 2

Me Planin Rregullues Urban "*Tregti dhe Industri te Vogël*" të qytetit të Prizrenit, janë të përfshira hapësirat-Lokacionet që gjenden në zonën perëndimore të qytetit dhe ka sipërfaqe prej 142.3 ha dhe për-bënë 267 ngastra të madhësive të ndryshme ashtu që:

-Zona e Tregtisë dhe Industrisë së Vogël kufizohet me: perëndim - me ngastrat : 6542-0 , 90250-0 , 6536-0 , 6535-0 , 6534-0 , 6533-0 , 6531-0 , 11003-2 , 6649-0 , 11002-0 , 6713-0 , 6714-0 , 6719-0 , 6718-0 , 6717-0 , /ngastrat : 6535-0 , 6534-0 , 6533-0 , 6713-0 , 6714-0 ndahen nga kufiri në skajet e tyre , ndërsa ngastrat 90250-0 , 11003-2 , 11002-0 janë ngastra që u përkasin rrugëve / ; në veri me rrugën "Turgut Ozall" në lindje me rrugën "Tirana" dhe në jug me rrugën "Elbasani "

(Vërejtje: Ngastrat e pa definuara janë përshkruar si "x" -si pasoj e mungesës se informatave nga Drejtoria për Gjeodezi)

Neni 3

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi është planifikuar zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale për zhvillimin e ardhshëm të Prizrenit, me qëllim që t'ju mundësojë qytetarëve jetën në një qytet me planifikim urban dhe kushte të sigurt për investim ku është paraparë tregti dhe industri e vogël.

Neni 4

Ky Vendim bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1, dhe 2 të këtij Vendimi do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit


Neni 5

Plani Rregullues Urban është hartua për periudhën kohore më së paku 5- (pesë) vjeçare, ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në Web faqen e Komunës.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi Komunal
Nr. 01/011-11860
Më 18 tetor 2012
Prizren



Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu